

Datë: 25 Janar, 2017

KONKLUZIONE
NGA
KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

'Draft Rregullore për Regjistrimin e Parapaguesve të Telefonisë mobile'

Dokumenti 'Draft Rregullore për Regjistrimin e Parapaguesve të Telefonisë Mobile' (tutje referuar si - Rregullorja) është përgatitur mbështetur në nenin 10 paragrafi 4), neni 64, neni 67, paragrafët 1) dhe 2), neni 79, paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (tutje referuar si; Ligji ose LKE). Sipas Vendimit Nr. 862 (Ref. ARKEP Nr. Prot. 029/B/16) Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si - ARKEP ose Autoriteti) ka miratuar inicimin dhe fillimin e procedurës së Këshillimit Publik, e cila ka zgjatur nga data; 19 Shtator 2016 deri më datë; 18 Tetor 2016. Draft rregullorja gjithashtu është publikuar në web faqen e ARKEP-it, përkatësisht në linkun: <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,13,941>.

Gjatë periudhës së Këshillimit Publik komente kanë dërguar operatorët Telekom i Kosovës Sh.A. (tutje referuar si - Telekom i Kosovës) dhe IPKO Telecommunications LLC (tutje referuar si - IPKO);

- 1) **Komentet e Telekom i Kosovës**; janë dërguar më datë; 18/10/2016 (Ref. ARKEP Nr. Prot.849/2/16), dhe
- 2) **Komentet e IPKO-së**; janë dërguar më datë; 13/10/2016 (Ref. ARKEP Nr. Prot.811/2/16; IPKO Nr.Prot.5493).

Bordi i Autoritetit pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga operatorët, në mbledhjen e 13 me radhë të mbajtur më datë 20 Janar 2017 ka miratuar Rregulloren së bashku me përgjigjet/qëndrimet e ARKEP ndaj komenteve të dërguara, të cilat janë paraqitur në tabelat si në vijim (Shtojcat I dhe II).

Rregullorja së bashku me përgjigjet e ARKEP publikohen në web faqen: www.arkep-rks.org.

SHTOJCA I

Përgjigjet e Autoritetit ndaj komenteve të operatorit 'Telekomi i Kosovës'

Nr.	Neni Referent i Draft Rregullores	Komentet e Telekomit të Kosovës SH.A.	Përgjigja/Qëndrimi e ARKEP-it
1.	<p>Neni 7 (Obligimet dhe të drejtat e ofruesve të shërbimeve), paragrafi 2):</p> <p>Ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si parapagues më tepër se 5 SiM kartela.</p>	<p>Sqarim:</p> <p>Pika 7.2 Ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si parapagues i më tepër se 5 SiM kartela.)</p> <p><i>Këtë kufizim aktualisht nuk e përkrah CRM, por, do të diskutohet me OE se si mund të aplikohet kjo në të ardhmen. Por, nëse kjo rregullore hyn në fuqi para se të jetë i mundshëm ky kufizim në sistem, opsionale është që kjo të kufizohet nga vetë operatorët sepse me rastin e shitjes përmes ID kartelës sistemi i liston të gjithë numrat që lidhen me po atë ID.</i></p>	<p>Ofruesit e shërbimeve janë të obliguar të kufizojnë numrin e SiM për një parapagues, ndërsa implementimi teknik është çështje e tyre.</p> <p>Ndryshohet neni 7, paragrafi 2) si në vijim:</p> <p><i>"Ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si parapagues më tepër se dhjetë (10) SiM kartela"</i></p>
2.	<p>Neni 7 (Obligimet dhe të drejtat e ofruesve të shërbimeve), paragrafi 4):</p> <p>Obligohen Ofruesit e shërbimeve që të bëjnë aktivizimin e SIM Kartelës menjëherë pas kërkesës së parapaguesit por jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së saj. Ky shërbim do të jetë pa pagesë.</p>	<p>Sugjerim/Vërejtje:</p> <p>Pika 7.4 Obligohen Ofruesit e shërbimeve që të bëjnë aktivizimin e SIM Kartelës menjëherë pas kërkesës së parapaguesit por jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së saj. Ky shërbim do të jetë pa pagesë.</p> <p><i>Afati 24 orë i aktivizimit është maksimalisht i mjaftueshëm për aktivizim të numrave në përgjithësi, por, në këtë pikë sugjerojmë të shtohet edhe pjesa "në rast të mbingarkesave të mundshme deri 48 orë" (apo një fjali e ngjashme). Kjo me qëllim që në rast se ka mirëmbajtje të planifikuar në ndonjë pjesë të caktuar dhe mund të shfaqet ndonjë pengesë eventuale në aktivizime të reja të figuroj si preventivë.</i></p>	<p>Ndryshohet neni 7, paragrafi 4) si në vijim:</p> <p><i>"Obligohen Ofruesit e shërbimeve që të bëjnë aktivizimin e SIM Kartelës menjëherë pas kërkesës së parapaguesit por jo më vonë se brenda afatit 24 orësh pas paraqitjes së saj, kurse në rast të mbingarkesave afati maksimal është 48 ore. Ky shërbim do të jetë pa pagesë."</i></p> <p><u>KOMENTI PRANOHET</u></p>

SHTOJCA II

Përgjigjet e Autoritetit ndaj komenteve të IPKO-së

Nr.	Neni Referent i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-s.	Përgjigja/Qëndrimi e ARKEP-it
1.	//	<p>Komentet e përgjithshme:</p> <p>Duke e ditur se qëllimi i miratimit të Rregullores për regjistrimin e parapaguesve, si dhe amandamentimit të njëjtës është që t'i shërbej organeve hetimore në Kosovës, është shumë me rëndësi që informatat në format e regjistrimit të jenë të sakta. Saktësia e tyre mund të garantohet vetëm nëse operatorët lejohen që të depozitojnë kopjet e dokumenteve identifikuese, e cila do të mundësonte që format e regjistrimit të kontrollohen dhe informatat që i ofrohen organeve kompetente të jenë të sakta.</p> <p>Duke u nisur nga kjo, IPKO kërkon nga ARKEP që në bashkëpunim me Agjensionin për Mbrojtjen e të dhënave personale, të nxjerrin një vendim me të cilin do t'i lejonin ofruesit e shërbimeve të depozitonin kopjen e dokumentit personal. Duke qenë se më datë 22.12.2011 me anë të vendimit me numër 7/1, IPKO është urdhëruar nga Agjensioni për mbrojtjen e të dhënave personale, që duke filluar nga data 01.01.2012 të mos depozitoj asnjë kopje të dokumentit që përmban të dhëna personale, dhe të bëj shkatërrimin e të gjitha kopjeve fizike që përmbajnë të dhëna personale të parapaguesve, nga ajo kohë IPKO ka hasur në vështërsi të vazhdueshme për validimin e të dhënave personale sepse parapaguesit nuk janë paraqitur në pikat e shitjes së IPKO-s për përditësimin e të të dhënave personale kur ka qenë e nevojshme. Mos depozitimi i kopjes së letërnjoftimit ka shkakëtuar edhe pengesa sa i</p>	<p>Plotesohet neni 6, duke shtuar një paragraf të ri si në vijim:</p> <p><i>“Të dhënat personale të perdorura nga ofruesit e shërbimeve gjate regjistrimit të parapaguesve duhet të ruhen në përputhje me ligjin për të dhënat personale.”</i></p> <p><u>KOMENTI PJESËRISHT PRANOHET</u></p>

		<p>përket hetimeve të organeve hetimore, respektivisht masave të fshehta.</p> <p>Prandaj, derisa të mos lejohet një gjë e tillë, IPKO nuk mbanë asnjë përgjegjësi ndaj organeve hetimore dhe as ndaj ARKEP, për respektimin e kësaj rregulloreje, meqenëse është e pamundur në mënyrën siç është bërë drej tani. Depozitimi i kopjes së dokumentit identifikues do të lehtësonte dukshëm verifikimin e të dhënave nga ana e Autoriteteve dhe përshpejtimin e hetimeve nga ana e tyre.</p> <p>Para se të lëshohemi në nenet përkatëse, ju lusim të evitoni gabimin teknik tek definicioni i parapaguesit tek paragrafët (2.2.b), si dhe tek paragrafi 7.6.</p>	
2.	<p>Neni 3 (Obligimet e parapaguesve): Obligohet që çdo parapagues qoftë person fizik apo juridik, pasi që të blejë SIM Kartelën të paraqitet në ndonjë vend nga pikat e shitjes së ofruesit të shërbimeve, ose në ndonjë vend tjetër të përcaktuar nga ofruesi për të bërë aktivizimin e saj.</p>	<p>IPKO propozon të shtohet paragrafi në vijim:</p> <p><i>“Nga ky obligim lirohen personat fizik dhe juridik që kanë të lidhur/nënshkruar kontratë me operatorin për përdorimin e shërbimeve post/paid me pagesë mujore. Kontrata e nënshkruar nga palët duhet të ketë informatat e njëjta sikurse forma e regjistrimit e miratuar nga ARKEP”.</i></p> <p>Arsyetimi:</p> <p>IPKO propozon që personat juridik dhe të gjithë parapaguesit post-paid të përjashtohen nga ky obligim i paraqitjes në pikat e shitjes për regjistrim dhe plotësimi i formës për regjistrim, duke qenë se personat juridik dhe parapaguesit e shërbimeve Post-Paid me rastin e lidhjes së kontratës për shërbimet e telefonisë mobile të</p>	<p>Plotesohet neni 3, duke shtuar një paragraf të ri si në vijim:</p> <p><i>“Pavaresisht nenit 3.1 personat fizik dhe juridik me parapagim mujor (post-paid) përjashtohen nga ky proces në qoftë se kontrata e lidhur i përmbanë të gjitha informatat e specifikuar në formularin e regjistrimit.”</i></p> <p><u>KOMENTI PRANOHET</u></p>

		IPKO's deklarojnë të dhënat e tyre personale, të cilat plotësohen nga ana e IPKO's në formën e kontratës për shërbime të telefonisë mobile. Prandaj konsiderojmë që ky obligim është i panevojshëm për parapaguesit e shërbimeve post paid dhe personat juridik, dhe i nevojshëm vetëm për personat fizik, të cilët shfrytëzojnë shërbime prepaid.	
3.	<p>Neni 6 (Verifikimi i informatave dhe dokumentet e nevojshme për verifikim), paragrafi 2):</p> <p>Për verifikim të informatave nevojitet njëra nga këto dokumente identifikuese:</p> <p>a) Letërnjoftimi;</p> <p>b) Pasaporta;</p> <p>c) Patentë shoferi;</p> <p>d) Autorizimi i vërtetuar nëse regjistrohet ndonjë person fizik ose juridik.</p>	<p>IPKO propozon që të shtohet fjalia si në vijim:</p> <p><i>"6.2 Për verifikim të informatave nevojitet njëra nga këto dokumente identifikuese, kopja e të cilave duhet të depozitohet nga operatori me qëllim të validimit të saktësisë së të dhënave në formën e regjistrimit nga ana e operatorit."</i></p> <p>Arsyetimi:</p> <p>Ashtu siç e kemi cekur në pjesën e parë të këtij dokumenti "Komente të përgjithshme", IPKO propozon që të depozitohet kopja e letërnjoftimit për hir të validimit të dhënave personale, pasi që në mungesë të kopjes së letërnjoftimit nuk është e mundur të bëhet validimi i saktësisë së të dhënave. Kjo ka rezultuar edhe në gabime gjatë hetimeve të organeve kompetente në Kosovë.</p>	<p>Shih komentin më lartë (Ref. Komenti nr.1).</p> <p><u>KOMENTI PJESËRISHT PRANOHET</u></p>
4.	<p>Neni 7 (Obligimet dhe të drejtat e ofruesve të shërbimeve), paragrafi 2):</p> <p>Ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si parapagues më tepër se 5 SiM kartela.</p>	<p>IPKO propozon që të ndryshohet fjalia si në vijim:</p> <p><i>"7.2 ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si parapagues më tepër se 15 SIM kartela brenda periudhës 5 vjeçare".</i></p> <p>Arsyetimi:</p> <p>IPKO propozon që të rritet numri i regjistrimit të</p>	<p>Ndryshohet neni 7, paragrafi 2) si në vijim:</p> <p><i>"Ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si parapagues më tepër se dhjetë (10) SiM kartela.</i></p> <p><u>KOMENTI PJESËRISHT PRANOHET</u></p>

		SIM kartelave për një person fizik nga 5 në 20 SIM kartela duke qenë se IPKO ka vërejtur se ka shumë parapagues familjarë të cilat marrin si pako më shumë se 5 SIM kartela dhe më së shumti deri në 15 apo 20 SIM kartela. Prandaj minimumi per 15 sosh duhet të ekzistoj.	
5.	<p>Neni 8 (Ndryshimi i parapaguesit/Humbja e SIM kartelës/vjedhja), paragrafi 1):</p> <p>Obligohet parapaguesi që në rast të shitjes/tjetërsimit të SIM Kartelës ai duhet të njoftojë ofruesin e shërbimit për një gjë të tillë. Pas kësaj ofruesi i shërbimit do të bëjë regjistrimin e parapaguesit të ri.</p>	<p>IPKO propozon që të ndryshohet paragrafi si në vijim:</p> <p><i>“8.1 Obligohet parapaguesi që në rast të shitjes/tjetërsimit të SIM kartelës ai duhet të njoftoj me shkrim në ndonjërin nga pikat e shitjes së ofruesit të shërbimit dhe parapaguesi i ri i SIM kartelës të ofroj shënimet e tija për regjistrimin e SIM kartelës si parapagues i ri”</i></p> <p>Arsyetimi:</p> <p>Kjo vlenë me qëllim të vërtetimit/verifikimit të numrit total të SIM kartelave të regjistruara nga ana e një parapaguesi.</p>	<p>Ndryshohet neni 8, paragrafi 1) si në vijim:</p> <p><i>“8.1 Obligohet parapaguesi që në rast të shitjes/tjetërsimit të SIM kartelës ai duhet të njoftoj me shkrim në ndonjërin nga pikat e shitjes së ofruesit të shërbimit dhe parapaguesi i ri i SIM kartelës të ofroj shënimet e tija për regjistrimin e SIM kartelës si parapagues i ri.</i></p> <p><u>KOMENTI PRANOHET</u></p>
6.	<p>Neni 8 (Ndryshimi i parapaguesit/Humbja e SIM kartelës/vjedhja), paragrafi 3):</p> <p>Në rast të humbjes së SIM Kartelës ose dyshimit për vjedhje të saj, parapaguesi duhet që menjëherë të lajmërojë Ofruesin e shërbimit, i cili obligohet që menjëherë të bëjë ndërprerjen e përkohshme të shërbimit.</p>	<p>IPKO propozon që të shtohet fjalia si më poshtë:</p> <p><i>“ Në rast të humbjes së SIM Kartelës ose dyshimit për vjedhje të saj, parapaguesi duhet që menjëherë të lajmërojë Ofruesin e shërbimit, i cili në raste kur nuk ka ndonjë ndalesë obliguese nga Autoritetet relevante të Republikës së Kosovës obligohet që menjëherë të bëjë ndërprerjen e përkohshme të shërbimit.”</i></p> <p>Arsyetimi:</p> <p>Për faktin se lidhur me numrin ose SIM kartelën mund të ketë filluar ndonjë procedurë/kontest ligjor në të cilin IPKO nuk mund të ndërhyjë në asnjë mënyrë, ose është e obliguar që të mos ndërhyjë.</p>	<p>ARKEP pas konsultimit edhe me organet e rendit e konsideron të panevojshem ndryshimin e këtij paragrafi, pasi që të gjithë parapaguesit duhe të kenë trajtim të barabarte.</p> <p>Po që se do të bëhej një ndryshim i tillë në shumicën e rasteve ofruesit e shërbimeve nuk janë në dijeni për ndalesat eventuale dhe në anën tjetër do të demtohen vetë parapaguesit.</p> <p><u>KOMENTI NUK PRANOHET</u></p>

7.	<p>Neni 8 (Ndryshimi i parapaguesit/ Humbja e SIM kartelës/vjedhja), paragrafi 4):</p> <p>Ofruesit e shërbimeve përpara se të bëjnë ndërprerjen e përkohshme të shërbimit duhet të bëjnë verifikimin e parapaguesit.</p>	<p>Pas paragrafit 4 të nenit 8 të shtohet edhe fjalia:</p> <p><i>“Duke u përkujdesur se nuk ekziston ndonjë pengesë ligjore për të bërë ndërprerjen e përkohshme të shërbimit”</i></p> <p>Arsyetimi:</p> <p>Shih arsyetimin më lartë.</p>	<p>Shih komentin me lartë (Ref. Komenti nr.6).</p> <p><u>KOMENTI NUK PRANOHET</u></p>
8.	<p>Neni 8 (Ndryshimi i parapaguesit/ Humbja e SIM kartelës/vjedhja), paragrafi 5):</p> <p>Shërbimi do të qëndrojë i ndërprerë për aq kohë sa nuk kërkon parapaguesi të bëjë aktivizimin e sërishëm të SIM Kartelës, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e ndërprerjes së përkohshme.</p>	<p>IPKO propozon që afati kohorë prej 60 (gjashtëdhjetë ditësh) të ndryshohet në 30 (tridhjetë) ditë.</p> <p>Arsyetimi:</p> <p>Për faktin se ky afat nuk ka bazë ligjore dhe është tepër i gjatë. Si dhe do të jetë në pajtim me afatin në nenin 9.3 të kësaj Draft Rregulloreje.</p>	<p>Ndryshohet neni 8, paragrafi 5) si në vijim:</p> <p><i>“Shërbimi do të qëndrojë i ndërprerë për aq kohë sa nuk kërkon parapaguesi të bëjë aktivizimin e sërishëm të SIM Kartelës, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e ndërprerjes së përkohshme.”</i></p> <p><u>KOMENTI PRANOHET</u></p>
9.	<p>Neni 9 (Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare), paragrafët 1) dhe 2):</p> <p>9.1 Të gjithë ofruesit e shërbimeve obligohen të njoftojnë parapaguesit e tyre, të cilët kanë më tepër se 5 SIM kartela të regjistruara në emër të një personi fizik.</p> <p>9.2 Të gjithë parapaguesit aktual, të cilët janë persona fizik dhe kanë më tepër se</p>	<p>IPKO propozon që të ndryshohet paragrafi 9.1) si në vijim:</p> <p><i>“Të gjithë ofruesit e shërbimeve obligohen të njoftojnë parapaguesit e tyre, të cilët kanë më tepër se 15 SIM kartela të regjistruara në emër të një personi fizik.”</i></p> <p>Po ashtu të ndryshohet paragrafi 9.2) ku afati prej 6 muajve të zëvendësohet me 18 muaj.</p> <p>Arsyetimi:</p>	<p>Ndryshohet neni 9, paragrafët 1) dhe 2) si në vijim:</p> <p>9.1 Të gjithë ofruesit e shërbimeve obligohen të njoftojnë parapaguesit e tyre, të cilët kanë më tepër se 10 SIM kartela të regjistruara në emër të një personi fizik.</p> <p>9.2 Të gjithë parapaguesit aktual, të cilët janë persona fizik dhe kanë më tepër se 10 SIM kartela në emrin e tyre obligohen që të</p>

	<p>5 SIM kartela në emrin e tyre obligohen që të bëjnë çregjistrimin e SIM Kartelave të tyre brenda periudhës prej 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.</p>	<p>IPKO insiston që numri minimal i SIM kartelave të regjistruara nën një person nga 5 tëjetë 15 sosh. Një gjë e tillë as nuk do të pengonte hetimet e organeve kompetente, sepse kushdo që ka deri në 15 numra në emër të vet, e din saktë se kush është përdorues i secilës prej tyre.</p> <p>Duhet të merret parasysh se afati për çregjistrim të SIM kartelave prej 6 muajsh është afat shumë i shkurtër, sepse kemi të bëjmë me numër të lartë të numrave që duhet të çregjistrohen, shumica prej tyre në zona rurale ku IPKO nuk ka pika të shitjes, si dhe për faktin se një pjesë e tyre jetojnë jashtë Kosovës dhe brenda periudhës së përcaktuar nga ARKEP nuk do të jenë në gjendje të paraqiten në pikat e shitjes së IPKO's që të bëjnë regjistrimin e numrave në afatin e paraparë në Rregullore.</p> <p>Gjithashtu, kjo rregullore do ta obligoj IPKO'n që të deaktivizoj numra të cilët mund të jenë nën hetime, respektivisht nën masat e fshehta nga autoritetet kompetente, në të tilla raste IPKO nuk mund të ndërhyjë në asnjë mënyrë, ose është e obliguar që të mos ndërhyjë lidhur me numrin ose SIM kartelen.</p>	<p><i>bëjnë çregjistrimin e SIM Kartelave të tyre brenda periudhës prej 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.</i></p> <p><u>KOMENTI PJESËRISHT PRANOHET</u></p>
--	--	--	---